



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:134972

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05476766

**C.nr.506/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm /Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) me seli në Bulevardin “Bill Klinton” nr.3, ndërtesa e Elektro-Kosovës, kati II, nr.5 Prishtinë, kundër të paditurit Xh. (A.) Z. nga fshati B./Malishevë, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 1,388.13 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 20.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET** se paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), e ka tërhequr padinë që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.506/21 të datës 23.06.2021, kundër të paditurit Xh. Z. nga fshati B.-Komuna e Malishevës.

**A r s y e t i m**

Në këtë gjykatë, paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) ka ushtruar padi (nr.ref.192/18) me datë 23.06.2021, kundër të paditurit Xh.Z., me objekt kontesti kompensim dëmi në vlerë prej 1,388.13 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 14.02.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurit, i cili nga fletë kthesa rezulton se e ka pranuar me datë 04.03.2024 por nuk ka kthyer përgjigje.

Me datë 19.03.2024, përfaqësuesi i paditëses nga Departamenti Ligjor-Njësia për çështje kontestuese me seli në Gjakovë, ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën nr.1/218 për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se i padituri Xh.(A.) Z.e ka përmbushur obligimin në emër të rikthimit të humbjeve e cila është vërtetuar në bazë të transaksionit të konsumatorit dhe fletëpagesës së prezantuar nga i padituri, andaj paditësja ka kërkuar tërheqjen e padisë dhe nuk ka kërkuar aktvendim të veçantë, dhe po ashtu ka njoftuar se për këtë padi është realizuar edhe pagesa e taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.1 të LPK-së, e

cila parasheh që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Bazuar në faktin se paditësja e ka tërhequr padinë para se i padituri ta paraqes në gjykatë përgjigjen në padi dhe në rastin konkret nuk kërkohet pëlqimi i të paditurit, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Andaj, në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.506/21, datë 20.03.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**Udhëzim juridik:** *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*